

"TË QENIT BURRË NË SHOQËRINË KOSOVARE"

SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime



Ky raport u mundësua nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara UNFPA zyra në Kosovë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e SIT – Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNFPA-së ose Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

LISTA E AKRONIMEVE

DhBGj	<u>Dhuna me bazë gjinore</u>
DhF	<u>Dhuna në familje</u>
OJQ	<u>Organizata jo qeveritare</u>
OSBE	<u>Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë</u>
FES	<u>Friedrich Ebert Stiftung</u>
UNFPA	<u>Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë</u>
UNDP	<u>Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara</u>
LGBTQI+	<u>Lezbike, gej, biseksual, transgjinerë, queer, dhe interseks</u>
SHKK	<u>Shërbimi Korrektues i Kosovës</u>
QKSGJ	<u>Qendra Kosovare për Studime Gjinore</u>

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	6
METODOLOGJIA	10
Dizajni i studimit dhe mostrimi	10
Mbledhja e të dhënave	10
Analiza dhe rezultatet	12
DISKUTIMI	21
REFERENCAT	22

HYRJE

Ky hulumtim synon të shpjegojë dhe të analizojë çfarë do të thotë të jesh një burrë i ri në shoqërinë kosovare, si pritet që një burrë i ri të sillet, dhe sa e rëndësishme është për të t'i përmbushë këto pritshmëri në jetën e tij. Këto pyetje kanë rëndësi të veçantë për shkak të ndikimit të tyre në identitetin, rolin, dhe sjelljen e një burri të ri, si dhe në marrëdhëniet e tyre me shoqërinë dhe me gratë.

Pyetjet që hulumtimi kërkon t'u japë përgjigje janë: Çfarë është të jesh një burrë i ri? Si supozohet të sillet një burrë? Dhe sa kanë rëndësi këto pritshmëri në jetën e djemve të rinj dhe burrave?

// Nëse marrim parasysh diversitetin e madh që është prezent në botën e sotme, e po ashtu edhe faktin që Kosova po kalon nëpër tranzicion të madh social, e kemi parë të arsyeshme që këtë studim ta fokusojmë tek burrëria. Pikërisht në këtë tranzicion të madh shoqëror, këto pyetje mund të duken si të parëndësishme dhe të vjetruara. Përderisa shohim që kemi përparim në atë që njerëzit janë më pak gjykues ndaj asaj se çka pritet nga një gjini e caktuar, ka ende shumë punë për të arritur në një situatë të barazisë së vërtetë. Megjithatë gratë kanë bërë përparim frymëzues drejt kapërcimit të shekujve të diskriminimit bazuar në gjininë e tyre, ka ende shumë për të bërë. //

Në këtë realitet të ri, ne nuk konsiderojmë se studimi i "maskulinitetit", apo asaj se çfarë do të thotë të jesh burrë është bërë më pak i rëndësishëm. Përkundrazi, këto tranzicione dhe tensione shoqërore e bëjnë studimin e këtyre fenomeneve thelbësor. Ky hulumtim ka për qëllim që të kuptojmë nëse ndryshimet shoqërore po inkurajojnë të rinjtë të rishikojnë konceptin e "të qenit burrë" dhe nëse po ndodh një ndryshim i qëndrimeve tradicionale. Poashtu, hulumtimi synon të përshkruaj sjelljet dhe qëndrimet e burrave dhe djemve të rinj në Kosovë në lidhje me kuptimin e "të qenit burrë", duke adresuar shtypjen, paragjykimet, dhe ndjenjat e mangësisë që mund të ndjejnë në këtë kategori gjinore.

Bazuar në hulumtime të realizuara më parë mund të shohim drejtpërsëdrejti apo edhe tërthorazi atë se si sillen burrat në shoqërinë tonë dhe atë se çfarë pritet prej tyre. Sipas studimit "FES Youth Studies Southeastern Europe 2018/2019" të realizuar nga Friedrich Ebert Stiftung (2019) më parë në Kosovë, është vërejtur se ekziston një nivel i lartë i distancës sociale dhe pranueshmërisë së ulët të diversitetit të të rinjve për të varurit nga droga, ish të burgosurit dhe homoseksualët. Minoritetet seksuale janë grupi i popullsisë ndaj të cilëve haset niveli më i lartë i intolerancës. Ky studim

njëkohësisht ka treguar se 19% e meshkujve duket se janë duhanpirës të rregullt, ndërsa vetëm shtatë % e femrave pinë duhan rregullisht. Kurse sa i përket konsumimit të alkoolit, meshkujt janë ata që e konsiderojnë alkoolin më të pranueshëm. Ndër të tjera është pohuar se përvoja seksuale është gjithashtu më e përhapur tek meshkujt sesa tek femrat. Ndërsa, për sa i përket qëndrimeve të të anketuarve ndaj seksit, duhet theksuar se virgjëria është parë si çështje dinjiteti për të dyja gjinitë; këtë e besojnë 37 % e të anketuarve. 23 % deklarojnë se kjo është çështje dinjiteti, veçanërisht për vajzat.

Një analizë tjetër mbi qëndrimet e burrave dhe opinionet e grave ndaj barazisë gjinore në Kosovë, duke përdorur Pyetësin Ndërkombëtar të Burrave dhe Barazisë Gjinore gjeti se pjesa më e madhe e burrave dhe grave i takojnë kategorisë së moderuar të normave gjinore (OSBE & UNFPA Kosovo, 2018). Mirëpo, rreth 13% e burrave i takojnë kategorisë së ulët të normave gjinore në krahasim me gratë prej të cilave vetëm 1% i takojnë kësaj kategorie. Më specifikisht sa i përket dhunës në familje, 21% e burrave pajtohen pjesërisht dhe 7.1% e tyre pajtohen plotësisht se gratë duhet të tolerojnë dhunën që ta mbajnë familjen së bashku. Poashtu, 32.7% pajtohen pjesërisht dhe 7.1% pajtohen plotësisht se ka raste kur një grua meriton të goditet. Poashtu, ky studim thekson se burrat në Kosovë janë rritur në familje patriarkale ku gratë ishin të kufizuara në kuzhinë dhe në detyrat e rritjes së fëmijëve, ndërsa burrat ishin përgjegjës për marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe sigurinë financiare dhe fizike të familjeve të tyre. Shoqëria ishte e organizuar në atë mënyrë që disa role ishin të destinuara rreptësisht për burrat dhe të tjerët për gratë. Gjatë rritjes, dhuna u normalizua si pjesë e metodës disiplinore, duke përfshirë këtu edhe dhunën me bazë gjinore (DhBGJ). Hulumtimi më tutje ka pohuar se, përderisa gjërat kanë filluar të ecin ngadalë në drejtimin e duhur, marrëdhëniet e pushtetit në shtëpi për burrat dhe gratë sot nuk ndryshojnë shumë nga ato të prindërve të tyre. Në shumicën e familjeve, gratë ende pritet të jenë përgjegjëse për punët e shtëpisë pavarësisht statusit të tyre të punësimit, ndërsa burrat vazhdojnë të mbajnë barrën e plotë të sigurimit financiar. Për rrjedhojë, kompetencat e vendimmarrjes ose u ndahen burrave, ose ndahen në mënyrë të barabartë, por shumë rrallë ato janë në duart e grave. Detyrat e kujdesit për fëmijët ende konsiderohen si domeni i një gruaje dhe, edhe në skenarin më të mirë, burrat mund të angazhohen vetëm si dorë ndihmëse në këto detyra. Kështu, leja e atësisë shihet gjithashtu më shumë si ndihmëse e pushimit të lehonisë sesa një mjet drejt rritjes së përfshirjes së babait në edukimin e fëmijëve të tyre. Përveç kësaj, dhuna e përjetuar nga djemtë në fëmijëri zakonisht shoqërohej me shfaqje të sjelljes së dhunshme kur ata djem u rritën në burra. Qëndrimet homofobike ishin të përhapura në Kosovë duke pasur parasysh se homoseksualiteti ende konsiderohet si i panatyrshëm dhe i padëshiruar nga shumica e burrave dhe grave sot. Tiparet e kulturës së përdhunimit ishin të pranishme edhe në pikëpamjet e burrave dhe grave në Kosovë, ku fajësimi i viktimave në rastet e përdhunimeve nuk ishte i pazakontë.

Një tjetër studim i realizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj, 2021) thotë se pavarësisht faktit se Korniza Ligjore e Kosovës gjithashtu siguron qasje të barabartë për burrat dhe gratë në hapësira publike, marrjen e huasë, mundësinë për të poseduar pronë dhe tokë, si dhe për të trashëguar, ende ka një pjesë të kosovarëve që mendojnë se burrat dhe gratë nuk kanë të njëjtat të drejta pavarësisht. Deri në një e dhjeta e qytetarëve kosovarë besojnë se gratë nuk kanë të drejta të njëjta si burrat për të hyrë lirisht dhe në mënyrë të barabartë në hapësirën publike

(4%), kredi bankare (5%), posedim ose administrim të një prone (7%), të zgjidhen në pozita të larta vendimmarrëse politike (8%), të trashëgojnë (10%) dhe zotërojnë ose kenë qasje në tokë bujqësore (11%). Sipas ligjit, burrat dhe gratë kanë autorizim mbi organet e tyre dhe statusin e tyre civil dhe prindëror, si dhe për të marrë vendime për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeçare. Pavarësisht nga kjo, më shumë se një në katër qytetarë kosovarë (26%) besojnë se gratë nuk kanë të njëjtat të drejta ligjore si burrat për të vendosur për numrin e fëmijëve që duan të kenë. Edhe pse moshë minimale e martesës është 16 vjeç sipas vendimit të gjykatës për rrethana specifike dhe 18 në përgjithësi, 15% e qytetarëve kosovarë pohojnë se gratë nuk kanë të njëjtën moshë minimale ligjore për martesë si burrat. Pak më shumë se një në 10 qytetarë kosovarë (13%) pohojnë se gratë nuk kanë të njëjtat të drejta ligjore të kujdestarisë mbi një fëmijë pas divorcit. Më shumë se një në 10 e qytetarëve kosovarë pajtohen/pajtohen plotësisht që gratë dhe burrat duhet të kenë pagesa të ndryshme, madje edhe për të njëjtën punë, sepse janë të ndryshëm dhe kanë përgjegjësi të ndryshme në familje. Për më tepër, 9% e qytetarëve kosovarë pajtohen/plotësisht pajtohen se nëse gratë zgjidhen në pozitat kyçe vendimmarrëse, ato po shkelin të drejtën e burrave për të pasur pozita të tilla; 8% që vajzat duhet të mësohen të jenë bashkëshorte të mira dhe të kujdesen për punët e shtëpisë, kurse arsimit, roli i transportuesit, biznesi dhe udhëheqja janë për djemtë; dhe 6% se nëse gratë fillojnë të fitojnë pushtet, ato do të neglizhojnë detyrat e tyre për t'u kujdesur për punët e shtëpisë dhe do të shkatërrojnë ekuilibrin familjar.

Në një linjë me këto gjetje janë edhe ato nga studimi i realizuar nga Instituti Riinvest për Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP, 2022) në Kosovë mbi qëndrimet e të rinjve ndaj normave gjinore dhe sociale. Nga gjetjet e këtij studimi thuhet se normat tradicionale kulturore duket se dominojnë pikëpamjet e të rinjve për të drejtat dhe rolet e grave në shoqëri. Për shembull, djemtë/të rinjtë janë më të bindur se vajzat/të rejat se roli më i rëndësishëm i grave është të kujdesen për familjen. Megjithatë, duhet theksuar se rreth një e treta e të gjithë pjesëmarrësve në anketë ranë dakord se krijimi i familjes është roli më i rëndësishëm për gratë. Dallimet janë shumë më të larta kur bëhet fjalë për perceptimin e të anketuarve për përshtatshmërinë e burrave për të punuar jashtë shtëpisë kundrejt grave. Shumica e pjesëmarrësve në këtë studim besojnë se është e rëndësishme për të gjitha gjinitë për të mësuar se si të kryejnë aktivitete shtëpiake si pastrimi dhe larja. Megjithatë, kur merren parasysh punët tjera shtëpiake si hidraulika dhe kopshtaria, gjetjet sugjerojnë se shumica e të rinjve pajtohen se burrat/djemtë duhet të jenë më të përgatitur dhe të mësojnë se si t'i bëjnë këto detyra sesa gratë/vajzat.

Nga rezultatet e këtij hulumtimi nga instituti Riinvest për Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP, 2022) dallimet gjinore në qëndrime janë të dukshme mbi normat dhe prirjet shoqërore: djemtë/të rinjtë paragjykojnë ndaj vajzave/grave të reja që bëjnë seks para martesës, ndërsa këto të fundit nuk diskriminojnë. Djemtë/burrat e rinj priren të mendojnë se vajzat nuk janë aq të mira sa djemtë në studim të shkencave natyrore, si inxhinieria dhe matematika. Dallimet gjinore janë gjithashtu të dukshme në qëndrimet ndaj emocioneve dhe seksualitetit: djemtë/burrat e rinj janë më të gatshëm të justifikojnë përdorimin e tyre të dhunës fizike nëse ofendohen; dhe shumica e pjesëmarrësve në studim konsiderojnë se djemtë/të rinjtë do të preferonin të mos ishin miq me anëtarë të komunitetit LGBTQI+. Është interesante se vetëm një pakicë burrash dhe grash nga të anketuarit mendojnë se djemtë/të rinjtë nuk kanë nevojë të diskutojnë çështje personale me të tjerët.

Nëse mbështetemi te këto gjetje nga hulumtimet e lartpërmendura dhe nëse duam të besojmë se barazia gjinore nuk kufizohet brenda fushës së shqetësimeve të grave, atëherë rrjedh se kjo çështje është po aq e rëndësishme nga këndvështrimi i një gruaje sa edhe nga këndvështrimi i një burri. Duke pasur parasysh se për dekada, diskutimet dhe politikat për barazinë gjinore janë nxitur nga gratë dhe për gratë, koncepti themelor i këtij hulumtimi është të fokusohet pikërisht në atë pjesë që shpesh është anashkaluar - perspektiva e burrave për barazinë gjinore.

// Instrumenti kryesor përmes të cilit tentojmë të analizojmë këto fenomene është pyetësi "The Man Box" [Kutia e Burrit] i zhvilluar nga Promundo, Axe (2016), dhe që i referohet një grup besimesh, të komunikuara nga prindërit, familjet, mediet, bashkëmoshatarët dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë, që ushtron presion mbi burrat për të qenë në një mënyrë të caktuar. Nëpërmjet këtij studimi, ne demonstrojmë gjithashtu ndikimin e gjerë të këtyre besimeve në disa fusha të jetës së të rinjve. //

Këto presione u thonë burrave të jenë të vetë-mjaftueshëm, të jenë të ashpër, të jenë fizikisht tërheqës, të qëndrojnë besnik në role të ngurta gjinore, të jenë heteroseksualë, të kenë aftësi seksuale dhe të përdorin agresionin për të zgjidhur konfliktet. Për qëllimet e studimit, burrat në "Kutinë e Burrit" janë ata që i përvetësojnë më shumë këto mesazhe dhe presione. Të rinjtë jashtë "Kutisë së Burrit" janë ata që kanë dalë nga "kutia", dhe të cilët i refuzojnë këto ide dhe në vend të kësaj përqafojnë ide dhe qëndrime më pozitive, origjinale rreth asaj se çfarë duhet të besojnë burrat dhe si duhet të sillen.

METODOLOGJIA

Dizajni i studimi dhe përzgjedhja e mostrës

Kombinim i metodologjisë kualitative dhe kuantitative u përdor për eksplorimin e perceptimeve dhe qëndrimeve ndaj maskulinitetit dhe asaj se çfarë do të thotë të jesh burrë, si dhe nivelit të stresit të perceptuar në bazë gjinore në mesin e popullatës së përgjithshme në Kosovë. E gjithë mostra e këtij studimi është përbërë nga djem dhe burra, gjithsej 367. Me anë të mostrimit të qëllimshëm janë intervistuar (12) burra të rinj të moshës 18-35 vjeç, përmes intervistave gjysmë të strukturuar. Këta burra të rinj kanë qenë nga qytete, prapavija dhe statuse të ndryshme socio-ekonomike. Të gjithë të intervistuarit kanë qenë të etnicitetit shqiptar dhe qytetarë të Kosovës.

Poashtu, janë realizuar 5 fokus grupe në komuna të ndryshme të Kosovës me djem të shkollave të mesme të moshës 14-18 vjeç, dhe një fokus grup i realizuar me djem të rinj të cilët janë pjesë e masave edukative brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK), në qendrën korrektuese në Lipjan. Kurse sa i përket pyetësorit që është shpërndarë online, janë targetuar 300 djem/burra të rinj të moshës 18-35 vjeç.

TABELA 1.0 Të dhëna demografike mbi mostrën e targetuar përmes pyetësorit online

Gjinia <i>f</i>	Mosha	Etniciteti <i>f</i>
Burrë 300	Minimum 18	Ashkali 1
	Maksimum 35	Boshnjak 3
	Mesatare 23.51	Rom 1
		Shqiptar 295

Mbledhja e të dhënave

Të dhënat janë mbledhur në dy faza. Të gjitha të dhënat janë mbledhur gjatë periudhës shkurt - prill 2023. Të dhënat kualitative u mbledhën nëpërmjet intervistave të mbajtura fizikisht dhe platformës virtuale "Zoom", si dhe fokus grupeve të mbajtura me prezencë fizike në shkollat përkatëse. Të dhënat u analizuan në bazë të incizimit të diskutimeve dhe shënimeve të marra nga hulumtuesja. Dymbëdhjetë intervista të thelluara janë kryer me burra nga qytete të ndryshme të Kosovës (Gjakovë, Pejë, Gjilan, Prishtinë, Rahovec, Kamenicë, Fushë Kosovë, Deçan dhe Lipjan). Informatat nga intervistat e thelluara na kanë mundësuar të marrim një perspektivë shumëpalëshe mbi

zhvillimet aktuale, ndërjegjësimin dhe barrierat kryesore lidhur me barazinë gjinore dhe burrërinë në Kosovë. Intervistat kanë zgjatur 45 minuta dhe kanë qenë të tipit të gjysmë-strukturuar. Pyetjet e parashtruara gjatë intervistave kishin për qëllim të kuptojnë më tepër rreth perceptimeve mbi maskulinitetin dhe të qenit burrë në shoqërinë kosovare, barazinë gjinore, si dhe perceptimet ndaj dhunës me bazë gjinore si fenomen në shoqëri. Krahas intervistave të realizuara, janë realizuar edhe pesë (5) fokus grupe me nxënës (djem) të shkollave të mesme të Kosovës të grupmoshës 14-18 vjeç (Deçan, Gjilan, Dragash, Mitrovicë, dhe Rahovec) dhe një fokus grup i realizuar me djem të rinj të cilët janë pjesë e Shërbimit Korrektues të Kosovës, specifikisht me qendren korrektuese në Lipjan.

TABELA 2.0. Të dhëna demografike për fokus grupet e realizuara

Vendi i fokus grupit	Numri i pjesëmarrësve (f)	Mosha mesatare
Deçan	9	17.1
Dragash	9	16.5
Gjilan	9	16.5
Mitrovicë	7	16.42
Rahovec	10	17
ShKK-Lipjan	10	18.6

Të dhënat nga faza sasiore u mblodhën nëpërmjet pyetësorëve përmes internetit (online). Fillimisht, këto të dhëna u vërtetuan për sa i përket konsistencës së përgjigjeve dhe kontrolleve të kohës për plotësimin e çdo pjese të pyetësorit, në nivel individual të të anketuarve. Pas vërtetimit, të dhënat u analizuan ku popullatës së përgjithshme iu administrua pyetësori përmes internetit (online).

Pyetësori "Kutia e Burrit" i përdorur në këtë fazë mblodhi informata mbi qëndrimet dhe perceptimet e të anketuarve ndaj maskulinitetit. "Kutia e Burrit" i referohet një grupi besimesh të komunikuar nga prindërit, familjet, mediet, bashkëmoshatarët dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë, që ushtron presion ndaj burrave për të qenë në një mënyrë të caktuar. "Kutia e Burrit" është një masë vetë-raportuese prej 15 pikash e qëndrimeve normative gjinore të një burri, e ndarë në 7 shtylla: vetëmjaftueshmëria, të qenit i ashpër, atraktiviteti fizik, rolet e ngurta gjinore mashkullore, heteroseksualiteti dhe homofobia, hiperseksualiteti, dhe agresioni dhe kontrolli. Pyetësori mat nëse i anketuari i përvetëson fuqimisht normat mashkullore shoqërore ("brenda kutisë së burrit") ose i përbrendëson qëndrimet më të barabarta gjinore ("jashtë kutisë së burrit"). Të anketuarit janë përgjigjur nga 1-4 për deklaratat përkatëse (1-pajtohem fuqishëm, 2-pajtohem, 3-nuk pajtohem fuqishëm dhe 4-nuk pajtohem) ku pikët më të larta pasqyrojnë më shumë pikëpamje të barazisë gjinore.

Pyetësori i dytë i përdorur si pjesë e këtij studimi ka qenë **Masculine Gender Role Stress Scale [Shkalla e stresit në rolin gjinor maskulin]** që përbëhet prej 40 deklaratash mbi përvojën individuale të stresit të vetëperceptuar lidhur me rolet gjinore maskuline, e ndarë në pesë nën-shkallë: paaftësia

Të qenit burrë në shoqërinë kosovare

fizike, pashprehshmëria emocionale, nënshtrimi ndaj grave, inferioriteti intelektual, dhe dështimi i performancës. Aspekte të ndryshme të stresit të rolit gjinor maskulin të kapur nga shkalla përfshijnë stresin që lidhet me portretizimin si femëror, të qenit inferior ndaj grave ose dështimin e perceptuar në karrierë ose aktivitete seksual. Në këtë pjesë të pyetësorit pjesëmarrësit kanë deklaruar nga 1 në 6, se sa stresuese është për ta deklarata në fjalë, ku 1 qëndron për aspak stresuese dhe 6 qëndron për esktrimisht stresuese.

Analiza dhe Rezultate

Eksplorimi i presionit social

Kur i kemi pyetur pjesëmarrësit në fokus grupe dhe intervista se çfarë është për ta të qenit burrë, po ashtu i kemi pyetur se kush u ka thënë se ato veti e bëjnë një burrë. Kështu, shumica e pjesëmarrësve raportuan se prindërit e tyre i mësuhan ata të fshehin ndjenjat e nervozizmit ose frikës, me fjalë të tjera i inkurajuan “të bëhen të fortë”. Kjo gjetje vë në dukje faktin se të rinjtë nuk po e krijojnë vetë identitetin e tyre të ngurtë dhe të dëmshëm, ata i marrin këto mesazhe kufizuese nga burime me ndikim, përfshirë prindërit e tyre. Të rinjtë raportuan gjithashtu se kishin përjetuar presione të ngjashme nga partnerët e tyre romantikë dhe miqtë meshkuj.

“Me maskulinitet kuptoj një hegjemoni që i ka normat, rregullat, që për me e pranë ni djalë mrenda hegjemonisë ai djalë duhet me konë sundues, udhëheqës, agresiv, qikjo osht qaj maskulinitet që osht kriju, qajo hegjemoni që është kriju, ty për met pranë shoqnia duhesh me hec drejt, duhesh me pasë zonin pak ma të trashë, se ka shumë djem që nuk shquhen me maskulinitet edhe e shohim se qysh shoqnia, qikjo hegjemonia maskuliniste nuk e pranë në sistemin e vet, ja nisin me e bullizu me fjalë të ndryshme” - i intervistuar.

9 nga 12 e të intervistuarve pajtohen me faktin se shoqëria do t’i paragjykonte nëse i sheh duke u shoqëruar me anëtarë të komunitetit LGBTQI+, që na lë të kuptojmë se homofobia përforcohet edhe nga shoqëria. Përderisa 11 nga 12 e të intervistuarëve janë deklaruar se një burrë që i përket komunitetit LGBTQI+ është një burrë i vërtetë, rezultate të tjera kanë dalë nga fokus grupet. Në të gjitha fokus grupet e realizuara mbi 95% e pjesëmarrësve janë deklaruar se një burrë nga komuniteti LGBTQI+ nuk është një burrë i vërtetë.

Krahas ndikimit të partnerëve romantik, shoqëria (kryesisht meshkuj) dhe familja i përforcojnë normat gjinore në atë mënyrë që djemtë të jenë pjesë e rregullave të “Kutisë së Burrit”. Nga të intervistuarit kemi kuptuar se ata kishin veçanërisht të ngjarë të kishin hasur mesazhe në lidhje me vetë-mjaftueshmërinë, ashpërsinë dhe hiperseksualitetin e burrave.

Përbrendësimi i “burrërisë”

Deri në çfarë shkalle i përbrendësojnë burrat e rinj presionet sociale për të qenë burra brenda “Kutisë së Burrit”? Sa janë ata në gjendje që t’u bëjnë ballë këtyre forcave sociale shpesh shtypëse, dhe sa arrinjtë të jenë vetvetja dhe të përqafojnë anën e tyre emocionale?

Në përgjithësi, ne zbuluam se të rinjtë distancohen deri në një masë nga rregullat e “Kutisë së Burrit”, por nuk i refuzojnë ato plotësisht. Nëse krahasojmë gjetjet e të anketuarve online, të rinjtë kishin më pak gjasa të raportnin pajtueshmëri personale me rregullat e “Kutisë së Burrit” sesa të dhënat që i kemi kuptuar nga deklaratat e marra në fokus grupe dhe intervista në raport me atë se çfarë pret shoqëria e gjerë në lidhje me këto rregulla mbi atë se çfarë është të jesh burrë. Disa burra mund të jenë në gjendje të refuzojnë presionet kufizuese dhe negative sociale që lidhen me maskulinitetin, por një numër i madh i përqafojnë këto presione dhe versionin e burrërisë që ato e promovojnë.

“Goxha vonë jam vetëdijësu e jom emancipu për këtë se këto sene janë absolutisht normale, se nëse procesojmë emocione..., kom fillu me përqaqë babën pak ma shumë edhe e kom kuptu që babën s’e kom përqaqë qaq shumë po e kom përqaqë mamin, motrën,..e babit ia kom dhonë dorën”
- I intervistuar.

Në fokus grupe, është vërejtur se pjesëmarrësit kanë shprehur nocione kontradiktore mbi atë se a e kishin ata të mundur të dilnin nga “Kutia e Burrit”. Siç reflektoi një pjesëmarrës: “Me qenë burrë nuk do të thotë më të jesh maço tipik, por më tepër të jesh ai që mbron gruan, që mbron familjen dhe që mbron veten . Edhe pse në pamje të parë dukej se ky djalë i ri ndjente se shoqëria kishte kaluar nga pikëpamjet regresive “maço” të burrërisë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, ideja e tij për burrat që janë mbrojtës sugjeron një respektim të rregullave të “Kutisë së Burrit”.

Një tjetër pjesëmarrës në njërin prej fokus grupeve pohoi se burrat kanë ende status më të madh social se gratë, por se gratë kanë ndryshuar shumë krahasuar me rolet e tyre më parë:

“Femna osht me atë qëllimin që don me u bo e pavarur, tu fillu prej familjes vet, amo ka mu konë bashkëshorte e dikujt, gjithashtu ka me u bo e pavarur, me pasë paren e vet, po mendoj që te dytë osht frika e njejtë, të dy gjinitë e kanë një qellim t’caktum se shumica... Femra është shtylla e familjes për të gjitha gjanat, se nuk osht puna te ndjeshmëria dhe fiziku po te mentaliteti si kolektiv se qysh e kemi situatën me i pranu femnat n’shoqinë tonë për momentin se ka shumë raste ku femrat janë ma t’forta n’politikë për me zgjidhë probleme diplomatike sesa meshkujt, mendoj që po të dy gjinitë e kemi fizikun t’ndërtun jemi ndryshe, po na jep anët pozitive dhe negative, qato e përmbushim njoni-tjetrin”- Nga fokus grupi në Gjilan.

TABELA 3.0. Përgjigjet e vetëraportuara nga pyetësi online mbi rregullat e "The Man Box"

	Pajtohem Fuqishëm	Pajtohem	Nuk Pajtohem Fuqishëm	Nuk Pajtohem
Një burrë i cili flet shumë për shqetësimet, frikat dhe problemet e tij nuk duhet të respektohet edhe aq.	12 (4.0%)	50 (16.7%)	91 (30.3%)	147 (49.0%)
Burrat duhet t'i zgjidhin problemet e tyre personale vetë, pa kërkuar ndihmë nga të tjerët.	17 (5.7%)	53 (17.7%)	92 (30.7%)	138 (46.0%)
Një djalë i cili nuk u kundërvihet atyre që e ngacmojnë është i dobët.	23 (7.7%)	62 (20.7%)	76 (25.3%)	139 (46.3%)
Djemtë duhet të sillen si të fuqishëm edhe atëherë kur ndihen të frikësuar ose të shqetësuar përbrenda.	44 (14.7%)	111 (37.0%)	51 (17.0%)	94 (31.3%)
Një djalë i cili shpenzon shumë kohë rreth dukjes së tij nuk është aq mashkullor.	15 (5.0%)	41 (13.7%)	86 (28.7%)	158 (52.7%)
Është shumë e vështirë për një burrë të jetë i suksesshëm nëse nuk duket bukur.	7 (2.3%)	32 (10.7%)	101 (33.7%)	160 (53.3%)
Gratë nuk u vihen pas burrave të cilët preokupohen shumë për rrobat, flokët dhe lëkurën.	6 (2.0%)	65 (21.7%)	84 (28.0%)	145 (48.3%)
Nuk është mirë që një burrë të mësohet si të gatujë, qepë, pastrojë shtëpinë, dhe të kujdeset për fëmijët e vegjël.	11 (3.7%)	15 (5.0%)	132 (44.0%)	142 (47.3%)
Një bashkëshort nuk duhet të bëjë punë të shtëpisë.	9 (3.0%)	20 (6.7%)	126 (42.0%)	145 (48.3%)
Burrat duhet të jenë ata që sjellin të ardhura në shtëpi për të mbështetur familjen, jo gratë.	36 (12.0%)	51 (17.0%)	95 (31.7%)	118 (39.3%)
Një burrë gej nuk është një burrë i vërtetë.	110 (36.7%)	74 (24.7%)	43 (14.3%)	73 (24.3%)
Është në rregull dhe normale që djemtë heteroseksual të jenë shokë me djemtë gej.	55 (18.3%)	106 (35.3%)	53 (17.7%)	86 (28.7%)
Një burrë i vërtetë duhet të ketë sa më shumë partnerë/e seksual/e që të mundet.	13 (4.3%)	16 (5.3%)	103 (34.3%)	168 (56.0%)
Një burrë i vërtetë nuk do t'i thoshte kurrë jo mundësisë për të kryer marrëdhënie seksuale.	15 (5.0%)	27 (9.0%)	101 (33.7%)	157 (52.3%)
Nëse është e nevojshme, burrat duhet të përdorin edhe dhunë për të fituar respekt.	12 (4.0%)	26 (8.7%)	126 (42.0%)	136 (45.3%)
Një burrë gjithmonë duhet të ketë fjalën e fundit për vendimet në marrëdhënien apo martesën e tij.	22 (7.3%)	46 (15.3%)	90 (30.0%)	142 (47.3%)
Nëse një djalë ka një të dashur ose grua, ai e meriton ta dijë se ku është ajo gjatë gjithë kohës.	47 (15.7%)	105 (35.0%)	57 (19.0%)	91 (30.3%)

Të rinjtë në pyetësonin e shpërndarë online dhe grupet e fokusit kishin veçanërisht të ngjarë të pohonin nocionet e burrërisë të lidhura me ashpërsinë dhe shtypjen e emocioneve. Të paktën 20 % ranë dakord me nocionin se “Një djalë i cili nuk u kundërvihet atyre që e ngacmojnë është i dobët,” dhe 37% që pajtohen e 15% që pajtohen fuqishëm me deklaratën se “Djemtë duhet të sillen si të fuqishëm edhe atëherë kur ndihen të frikësuar ose të shqetësuar përbrenda. Njëkohësisht ka pasur të rinj të tjerë në fokus grupe, përgjithësisht një pakicë, që thanë se ndryshimet në normat gjinore pra, barazia më e madhe midis burrave dhe grave dhe normat më egalitare shërbejnë në disavantazh për burrat.

“Te ne n’Kosovë nuk ka barazi gjinore... se mu m’doket palidhje nëse ni çikë i bon qato sene, e nese i bon mashkulli nuk m’doket diqysh se vet jom mashkull”- Djalë i ri nga fokus grupi në SHKK.

Rreth 23% e mostrës së anketuar online janë pajtuar me deklaratën se një burrë duhet t’i zgjidhë problemet vetë pa kërkuar ndihmë, e që është në përputhje edhe me deklarat e të rinjve në fokus grupe ku u pohua se shoqëria gjithmonë i lavdëron ata që u bëjnë ballë presioneve vetë. Dhe se pikërisht kjo aftësi për t’iu bërë ballë presioneve pa ndihmë ndërton karakter te burrat, dhe mbahen mend si më të suksesshem.

Sa i përket presionit që burrat mund ta ndjejnë, ka pasur një pajtueshmëri të përgjithshme të pjesëmarrësve mbi atë se për burrat është presion pjesa për të siguruar të ardhura monetare për familjen dhe në të njëjtën kohë siguri fizike e emocionale për të tjerët. Përderisa duhet të qëndrojnë stoik dhe të mos shprehin emocione edhe kur ndjehen të thyer.

“Mundesh me thonë presioni, në raste kur nuk mundet me siguru për familjen e vet, kur osht vështirë me komunu me to ose ndaj tina nuk kallxohet mjaftushëm dashni ose vëmendje ose këto, n’raste kur nuk ndihesh mirë me vlerë t’mjaftushme me njerëz që ka përreth, ose kur nuk mundet me i mbrri prishtëmëritë e t’tjerëve”

Në linjë me këtë deklaratë është edhe gjetja nga pyetësoni online i administruar mbi stresin e vetëperceptuar, ku 161 respondentë kanë raportuar se është ekstremisht stresuese për ta të qenit i pa punë dhe 141 që kanë raportuar se është poashtu ekstremisht stresuese për ta të mos arrijnë të sigurojnë mjaftueshëm të ardhura.

“Burrat mundohen për lumturinë e familjes dhe të ardhmen e fëmijëve”

A po ndryshojnë qëndrimet për rolet e burrave dhe grave në raport me kujdesin ndaj shtëpisë? Ndër fushat ku të anketuarit e pyetësonit online kanë pasur tendencë më të madhe për të mos u pajtuar me rregullat e “Kutisë së Burrit” kanë qenë ato që kanë pasur të bëjnë me kujdesin ndaj

Të qenit burrë në shoqërinë kosovare

shtëpisë dhe fëmijëve. Ka pasur një kundërshtim të madh me deklaratën “Një bashkëshort nuk duhet të bëjë punë të shtëpisë”, ku 42% nuk janë pajtuar fuqishëm dhe 48.3% nuk janë pajtuar me deklaratën.

Pjesëmarrësit nga fokus grupet dhe të intervistuarit u dhanë zë më tutje këtyre qëndrimeve. Një i ri i intervistuar u shpreh kështu:

“Përderisa nënat e reja i kanë 6 muaj pushim të lindjes edhe që paguhet 80% e rrogës për qata 6 muaj, pse për shembull në pjesën e dytë të viti të parë, dmth 6 mujorit e dytë të vitit të parë të fëmijës, edhe baballarët mos me i pasë 6 muaj, edhe nënat me punu.... gjithqysh duhet edhe baba me kon 6 muaj pushim me u kujdesë për fëmijë përderisa gruaja i punon”.

Njëkohësisht ky i ri shpreh dëshirën e tij që një normë e tillë të fillojë të ndryshojë në shoqëri. Më tutje një burrë tjetër nga të intervistuarit është shprehur kështu:

“Më kujtohet që gjyshi jem m’tregojke që fëmijët e tij nuk ka guxu me i mbajt në prehër për shkak që e kanë bullizu të tjerët, ndërsa tash burri ia qet edhe naj kafe grusë n’shpi edhe e nimon ka pak me punët e shpisë, me oborr e me mirëmbajtje, me ushqim.”

Megjithatë shpesh nga pjesëmarrësit e këtij hulumtimi është theksuar detyra e burrit për të siguruar të ardhura për familjen, si një prej definicioneve të burrërisë.

“Në shoqërinë kosovare osht’ vështirë me konë gru po edhe në anën tjetër osht’ vështirë me konë edhe burrë se pritet prej teje me konë siguruës i të ardhurave, se ti je burrë, ti je djalë, edhe pritshmëritë e krejt rrethit kanë me konë të tilla që ti duhesh me mbajt familjen, duhesh me siguru çështje ekonomie, osht goxha presion i madh. Duhesh me pasë t’ardhuna përmi mesatares, e nëse nuk i ki nuk konsiderohesh goxha burrë”- i intervistuar.

Citime të tilla në një anë mund të sugjerojnë se kur është fjala për qëndrime ndaj roleve gjinore në shoqërinë Kosovare, shumë burra janë në tranzicion mes ideve tradicionale të së kaluarës dhe qëndrimeve më egalitare ose të barabarta mes gjinive sa i përket roleve.

Mendimet personale të të anketuarve dhe të intervistuarve ishin shumë më progresive sesa presionet sociale kur vie puna tek homofobia, hiperseksualiteti dhe rolet shtëpiake, duke treguar një refuzim të fortë të rregullave “Të kutisë së burrit” në këto zona.

Kurse nga deklaratat e realizuara me fokus grupe ende vërejmë ide regresive mbi barazinë gjinore dhe përqafim të normave më të vrazhda gjinore mbi maskulinitetin. Dy pjesëmarrës nga fokus grupi i realizuar në Deçan janë shprehur kshtu:

“Gruja burrit t’vet i jep status, qysh sillet me to n’sy të tjerëve, n’sy t’shoqnisë e n’sy t’familjes tem, për shëmbull nëse gruja jem i qet kafe tonve qitu ajo mu m’jep status e jo me dal gruja me punu se qato kërkush s’ja nalë nëse don me bo paren e vet osht zgjedhja vet, po statusin që ja jep burrit osht qashtu qysh e përshkrupa une n’qat rast”

“Une vec e thashë, mashkulli që osht burrë qato limitet “rregullat” e veta që i ka, n’bazë qatyne duhet me u sill gruja, mos me i kalu qato limite e me nejt n’qat vend ku osht, për punë që mos me e qit keq burrin.. Nëse i kalon limitet, atëhere so gruja jote...”

Këta të rinj minojnë seriozitetin që kanë normat e vrazhda gjinore në shoqëri, duke reduktuar dhe shkrirë rolin e gruas si qenie njerëzore dhe identitetin e saj personal në një rol gjinor e social të paracaktuar, si vajza, gruaja, dhe nëna e dikujt.

Miqësia dhe kërkimi i mbështetjes

Cila është marrëdhënia midis ideve të të rinjve për maskulinitetin dhe afërsisë së miqësive të tyre dhe marrëdhënieve të tjera mbështetëse? Të rinjtë raportuan se kishin lidhje emocionale me miqtë e tyre, edhe pse grupet e fokusit zbuluan se shfaqja e cenueshmërisë emocionale ndaj miqve të tyre shihet si kundër rregullave të “Kutisë së Burrit”.

“Une nuk jom mbështetë kurrë te kërkush ...Domethonë për qato sa herë kom pas’ munim ose çkado, ose diçka që s’kom mujt me ndreq vet, s’osht që kom mujt m’u zgat te dikush, ose kur jom zgat te dikush s’osht diçka që kom mujt me ndreq vet m’kanë thonë, osht diçka që mundesh me kry, nuk osht diçka që duhesh mi bo presion vetes, qito s’po di.” - deklaratë e një të intervistuari në lidhje atë se ku mbështeten burrat kur kanë shqetësime emocionale.

“Unë mendoj që shumica e meshkujve nuk mbështeten te kërkush emocionalisht, qata mendoj që është edhe shkaktari kryesor i numrit të madh të vetëvrasjeve, tu i pa te të dy gjinitë, sa i përket vetëvrasjeve është shumë shqetësuese edhe mendoj që pikërisht këtu e ka zanafillën që meshkujt nuk po gjejnë dikon me u mbështet edhe mu çelë te ta edhe eventualisht me gjetë ni zgjidhje për probleme të tynë”- I intervistuar.

Të qenit burrë në shoqërinë kosovare

Në përgjithësi, burrat e intervistuar më tepër raportojnë se japin mbështetje emocionale për të tjerët, sesa që raportojnë cenueshmëri emocionale personale, ose kërkim të ndihmës.

Nga pyetësi online 134 burra të rinj kanë deklaruar se nuk është aspak stresuese për ta që të tjerët t'u thonë se janë shumë emocional, që përbën 44.7% të mostrës së anketuar online. Ndërsa në shumicën e deklaratave të marra nga intervistat dhe fokus grupet thuhet se djemtë/burrat e rinj të cilët qajnë dhe janë emocional shihen si më të dobët, dhe është e pranushme të qajnë para të tjerëve vetëm në raste të humbjes së njerëzve më të dashur.

Edhe pse disa të rinj shprehin gatishmërinë për t'u hapur emocionalisht me miqtë e tyre meshkuj, të gjeturat nga ky hulumtim tregojnë se ata vazhdojnë të mbështeten emocionalisht kryesisht tek gratë në jetën e tyre. Shumica e burrave ose djemve të rinj që kanë qenë pjesë e fokus grupeve kanë pohuar se burim parësor për mbështetje emocionale të një burri është nëna ose partnerja romantike (grua).

“Dhuna nuk është zgjidhje”

Të gjithë të intervistuarit dhe pjesëmarrësit në fokus grupe kanë deklaruar se parimisht dhuna nuk është zgjidhje dhe nuk duhet të jetë e tolereushme. Megjithatë ka pasur deklarata që e kanë arsyetuar dhunën në raste specifike, siç mund të jetë vetëmbrojtja, tradhëtia në marrëdhënie romantike, si dhe ka pasur deklarata që e kanë arsyetuar dhunën dhe gjuhën e urrejtjes ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTQI+, gjë që tregon për një tolerancë të ulët ndaj diversitetit.

Në të njëjtën kohë, të gjithë të intervistuarit janë deklaruar se djemtë inkurajohen për të qenë më të dhunshëm dhe të marrin pjesë në aktivitete të rrezikshme për ta dhe për njerëzit përreth. Ndër to është theksuar pirja e duhanit, ngasjet e pakujdesshme dhe përfshirja në përleshje fizike për të dëshmuar virtyte të burrërisë.

Prej gjetjeve nga analiza sasimore janë vërejtur qëndrime më tolerante nga burrat për mos përdorim të dhunës, ku 46 % e mostrës së targetuar nuk janë pajtuar dhe 25% nuk janë pajtuar fuqishëm me deklaratën se “Një djalë i cili nuk u kundërvihet atyre që e ngacmojnë është i dobët”, gjë që sugjeron se normat rigjide tradicionale që promovojnë ashpërsinë të burrat kanë filluar të ndryshojnë drejt atyre më progresive. Kurse sa i përket vërtetueshmërisë dhe të qenit figurë mbështetëse për të tjerët, 37% e mostrës së targetuar online pajtohen dhe 14.7% pajtohen fuqishëm me deklaratën “Djemtë duhet të sillen si të fuqishëm edhe atëherë kur ndihen të frikësuar ose të shqetësuar përbrenda.”

Nënshtrimi ndaj grave dhe seksualiteti

Bazuar në hulumtimet e mëparshme dhe gjetjet nga të dhënat cilësore të këtij hulumtimi Kosova është një shoqëri patriarkale, që nënkupton manifestimin dhe institucionalizimin e dominancës së burrave ndaj grave dhe fëmijëve në familje dhe përgjithsisht në shoqëri. Tradicionalisht nënshtrimi i grave ndaj burrave ka qenë ajo që e ka karakterizuar shoqërinë tonë. Për më tepër, historikisht gratë e kanë definuar veten në bazë të marrëdhënieve të tyre me burrat. Paksa në kontraditë me këto gjetje janë rezultatet që kemi hasur nga analiza sasiore e këtij hulumtimi, të cilat sugjerojnë se burrat kosovarë kanë filluar të përqafojnë idenë që gratë duhet të jenë pjesë aktive e vendimmarrjes dhe lidershit në shoqëri dhe kanë filluar të sfidojnë stereotipet gjinore. Nga mostra e studiuar online deklaratën “Të jesh me një grua që është me e suksesshme se ti”, 68% e mostrës e kanë vlerësuar si aspak stresuese. Më tutje 66.3% e kanë vlerësuar si aspak stresuese deklaratën “Të martohesh me dikë që fiton më shumë para se ti”, si dhe 43% e kanë vlerësuar si aspak stresuese, dhe 15% ekstremisht stresuese deklaratën “Kur bashkëshorti/ja jote duhet të punojë për të mbështetur familjen”.

Kur janë pyetur mbi stresin e vetëperceptuar, 48,7% e burrave të anketuar online kanë deklaruar se nuk është aspak stresuese për ta të lejojnë një grua të marrë kontrollin mbi situatën. Njëkohësisht 57% kanë deklaruar se nuk është aspak stresuese për ta kur një grua performon më mirë se ta në një lojë, dhe 52,7% kanë pohuar se nuk është aspak stresuese për ta të jenë me një grua që është më e gjatë se ta.

Sa i përket seksualitetit, norma dominante në qëndrimet e shoqërisë kosovare sipas deklaratave të pjesëmarrësve në intervista dhe fokus grupe është ajo që mbështet heteroseksualitetin, kurse nënkategoritë tjera nuk janë edhe aq të pranueshme. Pjesëmarrësit në fokus grupe janë deklaruar me neveri dhe duke përdorur gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTQI+. Kurse tek të intervistuarit është vërejtur një frymë më mbështetëse ndaj diversitetit dhe personave të komunitetit LGBTQI+. Bazuar edhe në gjetjet e të dhënave sasiore, ku janë vërejtur norma gjinore më egalitare, ndoshta mund të aludojmë se për të paktën një shtresë të shoqërisë kosovare me status socio-ekonomik më të lartë kanë filluar të ndryshojnë qëndrimet ndaj anëtarëve të këtij komuniteti, ose të paktën ndaj homoseksualëve.

Sipas gjetjeve nga analiza sasiore e të dhënave, deklaratën “Të perceptohesh nga dikush si “gej”, 33% e kanë vlerësuar si aspak stresuese dhe rreth 34 % ekstremisht stresuese. “Të perceptohesh si burrë me veti femërore”, 25% e kanë vlerësuar si aspak stresuese, 31% e kanë vlerësuar si ekstremisht stresuese dhe të tjerët që kanë deklaruar diku në mes të këtyre skajeve. Të mos jesh në gjendje të performosh seksualisht, 30% e kanë vlerësuar si ekstremisht stresuese dhe 15% që e shohin si aspak stresuese, kurse pjesa tjetër e mostrës kryesisht bien tek perceptimi i situatës si stresuese për ta. Të mos mund të eksitohesh seksualisht kur do 20% e kanë vlerësuar si aspak stresuese dhe 24% si ekstremisht stresuese.

Kalimi përtej rregullave të shoqërisë mbi burrërinë tradicionale

Procesi i kalimit në norma gjinore më egalitare, përkundër atyre të përshkruara te “Kutinë e Burrit” nuk është linear. Sado kontradiktore mund të duken disa nga gjetjet e këtij hulumtimi në një anë ato janë një pasqyrim logjik i dilemave me të cilat përballen të rinjtë në manovrimin me idealet kontradiktore të shoqërisë për burrërinë. Të rinjtë kanë disa përfitime nga përshtatja me rregullat që janë portretizuar tek “Kutia e Burrit”. Kjo u jep atyre një ndjenjë përkatësie, për të jetuar sipas asaj që pritet prej tyre. Miqtë dhe prindërit mund t’i lavdërojnë ata.

Megjithatë, kur të njëjtat rregulla u thonë burrave të jenë agresivë gjatë gjithë kohës, të ndrydhin emocionet dhe të luftojnë sa herë që dikush i kërcënon, këto rregulla kërkojnë që ata të shtiren se janë dikush që nuk janë, dhe rezultatet e studimit tregojnë se sa të dhunshëm dhe të vetmuar mund të përfundojnë këta djem.

Të rinjtë kanë nevojë për mbështetje për të dalë nga kjo normë e burrërisë dhe rrjedhimisht nuk mund ta bëjnë vetë. Vetëpeshimi i shpërblimeve dhe ndëshkimeve ndaj të qenit burrë sipas këtyre rregullave është ajo që e bën këtë një dilemë për të rinjtë.

Njëkohësisht pjesëmarrësit në fokus grupe e kanë theksuar që vetëbesimi në një anë, dhe të qenit i drejtë dhe i vërtetë ndaj vetes, janë faktorë që mund të ndihmojnë drejt konfrontimit të normave gjinore rigjide ndaj asaj që maskuliniteti duhet të ngërthejë.

Së pari, normat shoqërore dhe idealet për burrërinë janë komplekse dhe shumë burra kanë pikëpamje kontradiktore për to. Përqaftimi i qëndrimeve të cilat janë në përputhje me normat gjinore tradicionale mbi burrërinë ka përfitime për shkak se u siguron të rinjve një ndjenjë përkatësie, për të jetuar sipas asaj që pritet prej tyre. Rrjedhimisht, anëtarë të tjerë të shoqërisë, siç mund të jenë miqtë, prindërit dhe partnerët romantikë mund t’i lavdërojnë ata. Megjithatë, jeta bëhet e dhunshme dhe e vetmuar kur konformimi me këto norma u thotë burrave të mos jenë emocional dhe të jenë stoik.

Së dyti, nuk është e lehtë t’i konfrontosh këto norma gjinore tradicionale mbi burrërinë. Është e rëndësishme që e gjithë shoqëria të jetë pjesë e përkjekjeve për të përqaftuar norma gjinore më të barabarta të përkufizimit të burrërisë. Përputhja me normat gjinore tradicionale mbi burrërinë shpesh ofron një ndjenjë sipërfaqësore sigurie dhe vetëkënaqësie, ndërsa në të njëjtën kohë i detyron burrat të maskojnë pasigurinë, ndjenjën e izolimit dhe dëshirën për një lidhje më të thellë personale që “burrat e vërtetë” nuk supozohet të kenë.

KONKLUDIME

Në përgjithsi mund të themi se normat gjinore tradicionale mbi burrërinë të paraqitura si një grup rregullash të përforcuara shoqërisht për atë që duhet të bëjnë "burrat e vërtetë" (siç janë pasqyruar në pyetësonin "Kutia e Burrit") janë prezente në shoqërinë kosovare. Në të njëjtën kohë, shumica e burrave të intervistuar mbështesin idetë e barazisë gjinore dhe ata pohojnë se burrat duhet të inkurajohen të angazhohen në ato që dikur konsideroheshin si aktivitete tradicionale të grave, siç është kujdesi për fëmijët. Disa të rinj gjejnë një ndjenjë sigurie brenda këtyre rregullave tradicionale, edhe pse kjo u shkakton atyre dhe të tjerëve përreth tyre dëm.

Për disa të rinj, këto rregulla duket se janë një burim sigurie, ndoshta një mekanizëm me anë të të cilit ata pretendojnë se gjithçka është në rregull. Efektet e dëmshme që sjell pajtueshmëria me këto norma dhe rregulla të vrazhda janë të rënda, reale, dhe shqetësuese.

Shumica e burrave dhe djemve që u përmbahen rregullave tradicionale mbi burrërinë kanë më shumë gjasa të vënë në rrezik shëndetin dhe mirëqenien e tyre, të shkëputen nga miqësitë intime, të rezistojnë të kërkojnë ndihmë kur kanë nevojë, të përjetojnë depresion dhe mendojnë shpesh për t'i dhënë fund jetës së tyre. Njëkohësisht, të rinjtë që përshtaten me po këto rregulla kanë më shumë gjasa të kenë ushtruar dhunë ndaj të tjerëve.

Një trend i tillë po ashtu mund të jetë indikator që këta të rinj të kenë më shumë gjasa të përfshihen në sjellje të rrezikshme si pirja e tepërt e alkoolit, të jenë pjesë në aksidente trafiku dhe kanë më pak gjasa të kenë marrëdhënie të ngushta dhe miqësi.

Ky hulumtim shfaq nevojën për ndryshim të perspektivës mbi barazinë gjinore në situata të ndjeshme. Ofrimi i përkrahjes më transformative për barazi gjinore dhe paqe të qëndrueshme kërkon një kuptueshmëri të gjinisë, konfliktit, dhe ndjeshmërisë që është më e thellë, më e gjerë, dhe më e informuar politikisht, me një fokus të fortë tek burrat si agjentë të ndryshimit, duke u thelluar në nxjerrjen e rangut të tërë të lidhjeve ndërmjet gjinisë, konfliktit dhe ndjeshmërisë, duke përfshirë faktin se si pabarazia gjinore e formëson konfliktin dhe ndjeshmërinë; dhe kuptueshmërinë e marrëdhënieve të pushtetit që e nxisin pabarazinë gjinore, konfliktin dhe ndjeshmërinë dhe rolin e grave si aktore më shumë sesa thjesht si viktima pasive apo përfituese.

REFERENCA

Friedrich Ebert Stiftung (FES, 2019): Youth Studies Southeast Europe 2018/2019, marrë nga: <https://www.fes.de/en/youth-studies/>

Heilman, B., Barker, G., and Harrison, A. (2017). The Man Box: A Study on Being a Young Man in the US, UK, and Mexico. Washington, DC and London: Promundo-US and Unilever.

Kosovar Gender Studies Centre (KGSC, 2021): 2021 Public perceptions of gender equality and violence against women, marrë nga: [https://kgscenter.net/site/assets/files/1788/eng_equality_and_violence_against](https://kgscenter.net/site/assets/files/1788/eng_equality_and_violence_against_women_-_eng_with_cover.pdf)

women_-_eng_with_cover.pdf

OSCE Mission in Kosovo & UNFPA Kosovo (OSCE & UNFPA, 2018): A Men's Perspective on Gender Equality in Kosovo. Main Findings from the International Men and Gender Equality Survey (IMAGES), marrë nga: https://kosovo.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/English_0.pdf

United Nations Development Programme (UNDP, 2022): Youth Attitudes towards gender and social norms, development and human security in Kosovo, marrë nga: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-12/Youth%20Attitudes%20To%20ards%20Gender%20And%20Social%20Norms%20Development%20And%20Human%20Security%20in%20Kosovo%20-%20EN.pdf>

